



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 2266 Prot.

Vlorë, më 02 . 07 .2018

VENDIM

Nr. 22, Datë 27 / 06 /2018

**PËR MIRATIMIN E VENDIMEVE PËR KALIMIN NË PRONËSI TE PASURIVE TË
PALUAJTSHME TË NDËRTUARA DERI ME 10.08.1991, E TË TRUALLIT
FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDohen AKTE FITIMI PRONËSIE DHE
PËR REGJISTRIMIN E TYRE.**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 27.06.2018 në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të VKM - së 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësi, si dhe për regjistrimin e tyre” i ndryshuar si dhe të vendimeve të dërguara nga Bashkia Himarë.

VENDOSI :

1. Të miratojë Vendimin Nr.48, datë 01.06.2018 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin aplikues **Z. Vasillaq Bollano (subjekti Z. Vasillaq Bollano me gjeneralitetet e subjektit sipas çertifikatës së vitit 1991)** për një objekt banimi sipërfaqe ndërtimi 46.0 m² dhe sipërfaqe truall funksional 300.0 m², me vendndodhje në Lagjen “Cako” të qytetit të Himarës, zona kadastrale 1952, nr. pasurie 522/1 që kufizohet nga Veriu me Rrugë, Jugu me Rrugë, nga Lindja me Kullotë dhe nga Perëndimi me Kullotë.
2. Të miratojë Vendimin Nr.47, datë 31.05.2018 “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj” për subjektin aplikues **Znj. Katerë Vjero (trashëgimtarët sipas Dëshmisë së Trashëgimis Ligjore Nr.378 Rep, Nr.133/3 Kol më datë 21.04.2017)** për një objekt banimi dy kate, sipërfaqe ndërtimi 46.0 m² dhe sipërfaqe truall funksional 88.0 m², me vendndodhje në fshatin Vuno, Bashkia Himarë, zona kadastrale 3844, nr. pasurie 190 që kufizohet nga Veriu me Nako Gjini, Jugu me Rrugë, nga Lindja me Dhimitër Pano dhe nga Perëndimi me Shano Vjero.

Sekretari i Këshillit të Qarkut
Vllasi Nasaj

web site : www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 608